

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 4, datë 21.7.2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 2, DATË 15.11.2023, “PËR
NIVELIN KUFI TË ZHURMËS PËR NJË MJEDIS TË DHËNË DHE PËR
FUSHËN E VEPRIMTARIVE EKONOMIKE-SHOQËRORE”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të pikës 2, të nenit 2 dhe nenit 29, të ligjit nr. 9774, datë 12.7.2007, “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” i ndryshuar, ministri i Mjedisit, ministri i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe ministri i Punëve të Brendshme,

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin e përbashkët nr. 2, datë 15.11.2023, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 3, shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Përfshihet gjatë sezonin turistik, subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike apo sociale, të cilat lëshojnë zhurmë, si: lokale, bare, restorante, diskoteka, klube nate dhe veprimtari të tjera të ngjashme, të cilat përdorin muzikë të amplifikuar ose pajisje elektroakustike, marrin masa që:

a) prej orës 11:00 deri në orën 20:00, niveli i zhurmës i shkaktuar nga veprimtaria e tyre, i matur në mjedise publike të mos kalojë vlerën LAeq, 15 min prej 65dB(A), në çdo interval matje prej 15 minutash;

b) prej orës 20:00 deri në orën 24:00, niveli i zhurmës i shkaktuar nga veprimtaria e tyre, i matur në mjedise publike të mos kalojë vlerën LAeq, 15 min prej 45dB(A), në çdo interval matje prej 15 minutash.

Niveli specifik i zhurmës përcaktohet duke marrë në konsideratë zhurmën reziduale të mjedisit dhe sipas standardeve në fuqi për matjen dhe vlerësimin e zhurmës mjedisore.”.

2. Në shkronjën “a”, të pikës 6, togfjalëshi “prej 85 LAeq (dBA) dhe/ose 110 dB LAmax Fast (dB) në këto mjedise” zëvendësohet me togfjalëshin “ të përcaktuar në pikat 10 dhe 10/1 të aneksin 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi”.

3. Në aneksin 1, bëhen këto shtesa:

a) Pas pikës 10 shtohet pika 10/1 me këtë përmbajtje:

10/1	Mjedise publike, të jashtme të prekura nga muzika e amplifikuar e veprimtarive të parashikuara në pikën 3/1 të udhëzimit	Cenim i qetësisë (apo prishje e qetësisë) dhe shqetësim i komunitetit gjatë mbrëmjes.	65	15 minuta gjatë periudhës 11:00–20:00	--
			45	15 minuta gjatë periudhës 20:00–24:00	---

b) Tek shpjegimet shtohen:

LAeq,15 min = niveli ekuivalent i vazhdueshëm i presionit akustik, i ponderuar sipas shkallës A, i përcaktuar për një interval matjeje prej 15 minutash;

Zhurmë specifike = përbërësi i zhurmës së ambientit që i atribuohet veprimtarisë ose burimit që kontrollohet;

Zhurmë reziduale = zhurma që mbetet në mjedisin e matjes kur burimi specifik që kontrollohet nuk është në funksionim.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
Evis Sala

MINISTËR I MJEDISIT
Sofjan Jaupaj

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDASHME
Besfort Lamallari